



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISËDHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR TIRANË


PLANI I INTEGRITETIT PËR AGJENCINË RAJONALE TË EKSTENSIONIT BUJQËSOR TIRANË

2025-2027

Miratuar me Urdhërin Nr. 151/2 Datë 29.05.2025,të drejtorit të AREB Tiranë.

Z. Adriatik Beluli

**Koordinator i Integritetit
Specialist i Profilizuar për Statistikën
Drejtues i Grupit të Punës**



Grupi i Punës, antarë :

Dr. Zyhdi Çullhaj

Koordinator për të Drejtën e Informimit

Përgjegjës i Sektorit të Specialistëve të Profilizuar



Znj. Marsilda Dervishi

Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve



Z. Alfred Cengu

Përgjegjës i SEB Tiranë

20.04.25

Znj. Ornela Dedej

Specialiste Burime Njerzore, Arkiv -Protokoll



PLAN INTEGRITETI 2025-2027

Miraturar me Urdhërin e Brendshëm Nr 151/2 , datë 29.5.2025 të Drejtorit të institucionit.

Ky plan u realizua nga Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit, ngritur me Urdhërin Nr. 151/1 datë 19.05.2025. të Drejtorit të institucionit, si vijon:

Koordinatori : Adriatik Beluli, Përgjegjësi i Sektorit të Specialistëve të Profilizuar, Dr. Zyhdi Çullhaj, Përgjegjës i Sektorit Finances dhe Sherbimeve Marsilda Dervishi, Specialistja Burimeve Njerzore, Arshiv Protokoll Ornela Dedej , Përgjegjës i SEB Tiranë Alfred Cengu.

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të objektivit specifik A9 "Forcimi i integritetit të nënpunësve publike, specifikisht masa A.9.4 "Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planeve të integritetit nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive" .me afat zbatimi viti 2025-2027. të Planit të Veprimit 2025-2027 të Strategjise Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miraturar me VKM nr.247, datë 20.03.2015. të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publike, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësise së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

PERMBAJTJA

DEFKILARATA F INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
PLANI INTEGRITETIT	7
I.1 PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TE INTEGRITETIT	8
I.1.1 Ngritja e grupit te punes per bartimin e Planit te Integritetit.....	8
I.1.2. Identifikimi dhe analiza e riskut	8
I.1.3.Vleresimi i rësqeve te integritetit.....	9
I.1.4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut	9
I.2 QASJA METODOLOGJIKE	9
I.3 PERMBAJTJA E PLANIT TE INTEGRITETIT	10
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2025-2027.....	11
RISQET DHE FAKTORET E RISQEVE TE INTEGRITETIT	12
Fusha e buxhetit dhe menaxhimit financiar.	12
2.Fusha e menaxhimit te burimeve njerezore	13
3.Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit te dokumenteve dhe informacionit	13
4.Fusha e Ofrimit të informacionit për zbvillimin e sektorit bujqësor, agropërpunimit dhe rritjen e efïcenses se tyre.	14
III. PLANI I VEPRIMIT 2025-2027	14
III.1 Monitorimi dhe Raportimi i Planit të Veprimit.....	15

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Perballja efektive me korrupsionin për Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për fermerët dhe qytetaret e AREB Tiranë në zbatim të programit të qeverisë në fushën e bujqësisë, në përputhje me misionin dhe objektivat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. **Qellimi i Shërbimit të Ekstensionit** është të ofrojë formim profesional për të interesuarit në të gjithë territorin e AREB-it, për ta përdorur këtë formim për çështje që ndikojnë në përmirësimin e jetës së përditëshme të shtetasve dhe të fokusuara në aktivitetet e sigurimit të ushqimit dhe mirëpërdorimit të burimeve natyrore. Të ndihmojë njerezit të zhvillojnë aftësitë, të zgjidhjen e probleme të rëndësishme dhe të përmirësojnë familjet, format, bizneset dhe komunitetet e tyre.

Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe perkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion. Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të AREB Tiranë dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qellimi i tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tone do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për fermeret. Jerni të ndergjegjishëm së dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etike, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e fermerëve tek ne.

LISTA E SHKURTESAVE

MBZHR- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MVRI - Metodologjia e Vleresimit të Riskut të Integritetit

AREB -Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor
Tiranë

PLANI INTEGRITETIT

Plani i Integritetit per AREB Tiranë u hartua gjate periudhes 19.5.2025-29.5.2025. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vleresimit të Riskut të Integritetit (MVRI) dhe gjithashu në përputhje me Dokumentin e Manual të Vlersimi të Riskut të Integritetit . Qellimi i Planit te Integritetit ne kete institucion eshte:

- a) Vleresimi i risqeve te integritetit te cilat komprometojne aftesine e AREB Tiranë per te kryer funksionin e sherbimit publik ne menyre te paanshme dhe te pergjegjshme si dhe i faktoreve qe mund te mbeshtesin apo rrisin risqet e vleresuara.
- b) Formulimi i masave te pershtatshme per adresimin e tyre. Vleresimi i risqeve te integritetit dhe faktoreve te tyre eshte kryer per proceset e punes sipas fushave te veprimtarise te institucionit.

Këto fusha përfshijnë:

- Menaxhimin financiar
- Menaxhimin e burimeve njerezore
- Arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit;
- Ofrimin e informacionit per zhvillimin e sektorit bujqesor, agroperpunimit dhe rritjen e efijencës se tyre.

1.1 PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TE INTEGRITETIT

Menaxhimi i Riskut të Integritetit në AREB Tiranë përfshin zbatimin e 6 faza ve të mëposhtme të cilat janë të ndërlidhura me njëra- tjetrën. të cilat detajohen më poshtë :

- 1.Vendosja e objektivave ;
- 2.Identifikimi i risqeve ;
- 3.Vlersimi i Risqeve ;
- 4.Trajtimi i risqeve;
- 5.Plani Veprimi për Menaxhimin e Riskut dhe regjistri i riskut ;

Procesi i hartimit te Planit te Integritetit ne AREB Tiranë konsistoi ne zbatimin e fazave te meposhteme:

1.1.1 Ngritja e grupit te punes per bartimin e Planit te Integritetit

AREB Tiranë me Urdhrin e Brendshem Nr151/1, datë 29.5 .2025, ngritjen grupin e punes per vleresirnin e riskut te integritetit dhe hartimin e Planit te Integritetit. Ne perberje te grupit te punes janë Koordinatori Integritetit .Përgjegjësat e sektorëve kryesor te AREB Tiranë, te cilet kane siguruar mbarvajtjen e procesit, koordinimin e aktiviteteve si dhe realizoj procesin e identifikimit dhe vleresimit te risqeve te integritetit, si dhe hartimin e Planit te Integritetit.

1.1.2. Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjate kesaj faze, grupi i punes analizoi kuadrin ligjor ne fuqi, si dhe kuadrin e brendshem rregullator per veprimtarine e institucionit. Grupi i Punes vijoi me identifikimin dhe analizirnin e risqeve te integritetit dhe faktoreve te tyre, per proceset e punes ne fushat funksionale te AREB Tiranë .Pjese e kesaj analize ishin edhe te dhenat e mbledhura nga anketimi jo i strukturuar i stafit te institucionit mbi çështje te integritetit dhe etikes dhe ligjit mbi konfliktin e interesit ne institucion si edhe per te vleresuar njohurite e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural per integritetin ne institucion.

I.1.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit

Ne këtë fazë, grupi i punës vlerësoi risqet e analizuarat në fazën e mësipërme duke u mbështetur në mundësinë e risqeve për të ndodhur dhe në ndikimin në rast të ndodhjes së riskut. Ne vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditen sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan të dhënat e mbledhura nga intervistat me stafin e AREB Tiranë.

I.1.4. Plan i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtij Plan Integriteti është parashikuar për periudhën 2025-2027.

I.2 QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në AREB Tiranë, në përputhje me MVRI, për arsye të kohës së kufizuar për realizimin e tij, u përdor vetëm njëra nga tre metodat e përcaktuara në MVRI, pikërisht metoda sasore dhe cilësore - Përmes zhvillimit të intervistave dhe diskutimeve me stafin e institucionit, ku morën pjesë pjesë më të mëdha e punonjësve të institucionit, sidomos punonjësit më të vjetër në profesion, si dhe përmes analizës së kuadrit rregullator të brendshëm të institucionit (rregulloret e brendshme, procedura pune, plane pune etj).

Metodologjia është e mbështetur në disa parime të rëndësishme, zbatimi i të cilave ndikon në parandalimin e shkeljeve që çënojnë integritetin e institucionit. Ato përfshijnë :

- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënjes publike në punën e AREB –it me synim minimizimin e risqeve që dëmtojnë Integritetin e Institucionit. Zbatimi i këtij parimi

shërben si një garanci dhe për zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

- Forcimin e mekanizmit të kontrollit për AREB Tiranë, me qëllimin që çdo veprim i autoritetit duhet të jetë objekt për të ruajtur sistemin **kontrollo balancën dhe ndarjen e detyrave**.
- Thjeshtëzimin dhe riorganizimin e procedurave të zbatuara nga AREB Tiranë të cilat krijojnë mundësi për risqe integriteti.
- Minimizimin e pushtetit të tepërt në marrjen e një vendimi.
-

I.3 PERMBAJTJA E PLANIT TE INTEGRITETIT

Plani i Integritetit të AREB Tiranë është një instrument i luftës kundër korrupsionit ,me synimin që administrata të jetë profesionale,me etike,integritet dhe e angazhuar për tu shërbyer me korektësi fermerëve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.Ky planë përmban masat e nevojshme në funksion të fushave që mbulon.

Permbajtja e Planit te Integritetit paraqitet si me poshte:

- Deklarata e Integritetit Institucional.shprehja e vullnetit dhe perkushtimit per integritet institucional nga ana e titullarit te AREB Tiranë.
- Prezantimi i pergjithshem i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të AREB Tiranë, pershkrimi i fazave te procesit te planifikimit te integritetit dhe qasja metodologjike;
- Risqet e integritetit dhe faktoret e tyre i cili perfshin nje pershkrim te risqeve te integritetit dhe faktoreve te tyre ne fushat e pergjegjesise se institucionit.
- Plani i Veprimit. i cili permban masat e kontrollit qe duhet te ndermerren per te adresuar risqet e identifikuara dhe te vleresuara.

Prezantimi i pergjithshem i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të AREB Tiranë. pershkrimi i fazave te procesit te planifikimit te integritetit dhe qasja metodologjike: institucionit si dhe dokumentacioni i ndodhur prane institucionit te AREB Tirane

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2025-2027

Qëllimi Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, të cilat komplementojnë kapacitetet e strukturave të institucionit, i cili nepermjet ketij Planit Integriteti, AREB Tranë ka vendosur tre objektiva të realizueshem brenda periudhes 2025-2027, nepermjet të cileve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

Objektivi *perfundimtar* i ketij plani eshte ndertimi i nje sistemi të brendshem efektiv dhe forcimi i kultures se integritetit institucional. Objektivat strategjike 2025-2027 të Planit të Integritetit jane:

1. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerezore;
2. Përmisimi i sistemit të planifikimit, sigurimi i burimeve financiare dhe administrimit të buxhetit.
3. Sigurimi i informacionit bashkekohor për fushën e bujqesise.

Keto objektiva strategjike bazohen dhe perputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjise Ndersektorale Kunder Korrupsionit, si edhe me paketen e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparences në sektorin publik. Keto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhes së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtperdrejte të gjitha strukturat dhe nepunesit përgjegjes

RISQET DHE FAKTORET E RISQEVE TE INTEGRITETIT

Ne kete seksion paraqitet ne menyre te permbledhur analiza dhe rezultatet e procesit te vleresimit te riskut te integritetit ne AREB Tiranë . Pas kryerjes se procesit te vleresimit te riskut ne fushat e pergjegjesise se institucionit, rezultoi si ne vijim:

Fusha e buxhetit dhe menaxhimit financiar.

Pasi u verifikua dokumentacioni financiar, rezultoi se zyra e finances çdo fillim viti harton nje plan pune per te gjitha aktivitetet qe lidhen me fushen e finances dhe buxhetit, per realizimin e te cilit raporton rregullisht. Po ashtu, sipas udhezimeve perkatese nga Ministria e Financave dhe Ekonornise hartohet brenda afateve Programi Buxhetor Afatmesem. Te gjitha shpenzimet e institucionit perballohen me fonde nga Buxheti i Shtetit. Fondet buxhetore te miratuara sipas artikujve kontabel jane te mjaftueshrne per realizimin e veprimtarise se AREB Tiranë dhe ne asnje rast nuk jane krijuar detyrime te prapambetura.

Zbatimi i buxhetit vjetor monitorohet ne menyre progresive gjate vitit, rakordohet me Degen e Thesarit dhe raportohet edhe prane MBZHR-se.. Sa i takon aktiveve afatgjata dhe qarkulluese te institucionit, rezulton se kryhet inventarizimi, vleresimi dhe procedurat e daljes nga perdorimi te tyre sipas legjislacionit ne fuqi brenda afateve te percaktuara. Mbahet dhe perditesohet vazhdimisht regjistri i aktiveve te institucionit ku reflektohen edhe shtesat dhe pakesimet e aktiveve gjate vitit. I lidhur me fushen e prokurimeve publike, AREB Tiranë ngre çdo fillim viti Komisionin e Prokurimeve me Vlera te Vogla dhe me vleren nen 100.000 leke, i cili realizon procedurat e blerjeve. Per çdo proces te punes mbahen procesverbalet perkates. Gjithashtu, AREB Lushnje harton dhe miraton çdo vit regjistrin e parashikimit te prokurimeve publike dhe regjistrin e realizimit. Per te gjithë transaksionet financiare ruhet gjunna e auditit, si dhe te gjitha praktikat dhe dokurnentat ruhen dhe arkivohen sipas percaktimeve ligjore ne fuqi.

- Vleresirni i riskut te integritetit

Ne kete fushe nuk eshte evidentuar asnje risk

2.Fusha e menaxhimit te burimeve njerezore

Struktura e AREB Tiranë e miratuar me VKM t, nr. 147, date 13.3.2018 eshte e perbere nga 63 punonjes, nga te cilet 5 jane vende vakante. Gjithashtu ne strukturen e AREB Tiranë,sikurse dhe në ARFB -et e tjera nuk kanë organigramë që ti përgjigjet sfidave dhe prioriteteve në kuadër të integritetit në BE pa u sforcuar. Ka pozicione që mbulohen nga një specialist siç janë , arkiv-protokoll,burime njerëzore dhe magazina.Ndërkohë që Arkiv-protokolli,mund të ndahen si pozicion më vete nga burimet njerëzore si dhe magazina për shkak të ngarkesës së vogël mund të mbulohet nga punonjës me kontratë . Po kështu nuk ka nje pozicion jurist dhe specialist IT. Mungon Sektori Rajonal i Statistikës në nivel AREB Tiranë dhe për shkak të ngarkesës duhen shtuar dhe nga një specialist statistike tjetër në çdo qark te cilet jane te domosdoshem ne nje strukture te shtrire ne hapesire si institucion rajonal qe ne jemi,si dhe ne dinamikat gjithnje ne rritje te koheve te fundit dhe në referenc të vaktit që në çdo qark para këtij organizimi ka pasë nga sektor statistike me vete.

- Vleresimi i riskut te integritetit

- Risku i integritetit eshte vleresuar te jete ne nivel te mesem.

3.Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit te dokumenteve dhe informacionit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te administruar nga AREBTiranë , rezultoi se, modelet e dokumentave te perdorura nga stafi i institucionit jane te unifikuara. Gjithashtu, te gjithë dokumentat regjistrohen ne regjistra dhe libra protokolli duke marrë datë dhe numër protokollin e të cilës është përgjegjes specialisti i arkivë-protokollit. Ky specialist ka rolin kryesor në menaxhimin e fondit arkivor të institucionit. Po ashë dokumentacionin që përpunon institucioni.

- Vleresimi i riskut te integritetit

Në këtë fushë nuk eshte evidentuar asnje risk.

4.Fusha e Ofrimit të informacionit për zbvillimin e sektorit bujqësor, agropërpunimit dhe rritjen e efikasitetit të tyre.

Sektorët e Ekstensionit në AREB Tiranë kanë për detyrë, trajnimin e fermerëve për çdo problematike në fushën e bujqësisë, si dhe ofrimin e asistencës për aplikimin në skema apo grante të ndryshme. Trajnimi i tyre bëhet me anë të aktiviteteve që realizohen në fushë, si takime në grup, demonstrime, takime individuale etj. Për realizimin e këtyre aktiviteteve është shumë i nevojshëm një mjet shtesë levizjeje pasi në rajonin tonë zonat janë të shtrira në 3 qarqe . Deri tani në institucionin e AREB Tiranë, ka vetëm 2 mjete të amortizuara me të cilin është e pamundur që të realizohen të gjitha lëvizjet.

Vlerësimi i riskut të integritetit

-Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

5.Fusha e kontrollit të brendshëm kundër korrupsionit,transparencës ,këshillimit dhe implementimit të standarteve të BE-së.

Vlerësimi i riskut të integritetit

-Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

III. PLANI I VEPRIMIT 2025-2027

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së AREB-it Tiranë .

Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e

integritetit institucional. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

1.Proçese dhe rregulla sa më të qarta mbi aspektet e integritetit në AREB Tiranë ,me qëllimin të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit.

2.Burime njerëzore të konsoliduara,të qëndrueshme ,të kualifikuara dhe me trajnimet e nevojshme menaxhim më të mirë, për ti rezistuar shkeljeve të integritetit.

3.Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së AREB Tiranë me aktorë të ndryshëm dhe fermerë.

4.Sigurimi i informacionit bashkëkohor për fushën e bujqesisë.

III.I Monitorimi dhe Raportimi i Planit të Veprimit

Monitorimi është periodik me raporte 6 mujore dhe vjetore dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës.mbi zbatimin e masave të miratuara në këtë plan veprimi. Objektivat strategjike të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar. Implementimi i planit të integritetit do të monitorohet rregullisht nga Koordinator i Integritetit në Institucion. Koordinator është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit. Rezultatet e monitorimit të planit të integritetit do të bëhen publike në kuadër të praktikës institucionale të transparencës.Ky raport i lejon titullarët marrjen e masave shtesë për realizimin e objektivave me masat përkatëse.

PLANI VEPRIMIT

Objekti i 1: Konsolidimi i menaxhimit të sistemit të Burimeve Njerëzore në AREB Tiranë

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundëshme	Kategoria e faktorve të riskut	Intesiteti i riskut/prioriteti	Masat/aktivitetet Që duhen ndërmarrë për zbatim/Adresim	Struktura/Njësitë Përgjegjëse	Afati I Zbatimit	Shënime Plotësuse
1.	Hartimi i Hartave të punës për punonjësit e rinj në veçanti. Paketa ligjore dhe akte rënligjore.	Gabinet e mundëshme në realizimin e detyrave operacional	I mesëm	Njohja me detyrat në funksion të regullores.	Të gjithë sektorët e AREB Tiranë	Gjatë vitit 2025 dhe në kohezion.	
2.	Vakanca në AREB Tiranë	Pamundësi për mbulim teritori ,dhe efikasitet të plot në kryerjen e detyrave . operacional	I lartë	Ndjekja në kohezion te institucionet përgjegjëse me argumentimin përkatës	Burimet Njerëzore në bashkëpunim me titullarin e AREB Tiranë	6 Mujori II	
3.	Trajnim i vazhdueshmi stafit të AREB Tiranë në kuadër të Integrimit në 3E	Pamundësi për pëmbushje të sfidave të integrimit me efikasitet Operacional	I mesëm	Hartimi i një programi trajnimi në përputhje me kërkesat e kohës	ASPA e AREB Tiranë.	Gjatë vitit 2025 dhe në kohezion.	

4.	Ruajtja e Kujesës institucionale e vijushmëri e aktivitetit të strukturave të AREB Tiranë	Mos evidentim i plotë I Data Base në Arshiv nga sektorve të AREB operacional	I modernuar	Materiale informuse të dorzuar në protokoll për çdo pjesmarje në trajnim nga individët e grupet e punës	Të gjithë sektorët/Arkiv Protokoll	Gjatë vitit 2025 dhen ë kohezion	
5.	Kërkesë për ristrukturim institucioni,duke shtuar jurist, specialist IT .Ndarjen e pozicionit të burimeve njerzore nga arkiv-protokollit dhe magazine. Shtimin e një punonjësinë çdo SEB dhe krijimi I Sektorit të Statistikës në nivel AREB	Pamundësi e realizimit të detyrave dhe objektivave në në kohë,Mos azhronim në kohë me njojen e ligjeve dhe akteve ligjore të reja dhe vështirësi në interpretim. Operacional	I Lartë	Adresim i problematikave në institucionet përkatëse për gjegjëse	Titullari i Institucionit AREB dhe strukturat për gjegjëse.	Gjashtëmujori 2 I vitit 2025.	

Objekti 2 : Përmirësimi i sistemit të planifikimit, sigurimit i burimeve financiare dhe administrimit të buxhetit.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundëshme	Kategoria e faktorve të riskut	Intensiteti i riskut/prioriteti	Masat/aktivitetet që duhen ndërmarrë për zbatim/Adresim	Struktura/Njësitë Përgjegjëse	Afati i Zbatimit	Shënime Plotësuse
1.	Mosdërgimi në kohë dre me cilësi i informacionit për fondet në strukturat përgjegjëse në Ministri	Përputhshmëri	I moderuar	Mbajja në kontakt të vazhdueshëm dhe këshillimi i stafit të sektorëve ndryshëm të qëllim përmisimin e cilësisë së planifikimit	Të gjithë sektorët e AREB Tiranë	Gjatë vitit 2025 -2027 dhe në kohezion.	
2.	Mosardhja në kohë e udhëzimeve nga institucionet përgjegjëse.	Përputhshmëri	I moderuar	Mbajja e vazhdueshme e kontakteve me institucionet përgjegjëse	Sektori Finacë - Shërbime në bashkëpunim me titullarin e AREB Tiranë	2025-2027	
3.	Mosrakterdim i plotë i fondëve buxhetorë të kërkuar ,shpenzime operative dhe dhe investimet	Financiar	I moderuar	Argumentim sa më I plotë dhe teknik dhe ligjor i nevojave për Ifondeve	Sektori i Financës dhe Titullari	Gjatë vitit 2025-2027 në kohezion.	
4.	Vonesat e procedurave të Prkurimit	Operacional	I lartë	Ndjekja e afateve të procedimit sipas legjislationit.	Sektori Financës	Gjatë vitit 2025 dhen ë kohezion	

5.	Mospregatitja në kohë e gjithë dokumentave dhe pagesave financiare në zbatim të legjislacionit	Financiar	I lartë	Komunikim i vazhdueshëm me strukturat përkatëse	Sektor i Financës në bashkëpunim me Sektorët e tjerë.	Gjatë vitit 2025-2027 dhen ë kohezion	
6.	Moshedhja e gjithë informacionit financiar dhe ajo e asetëve në programin përkatës	Financiar	I mesëm	1.Mbledhja e të dhënave të nevojshme. 2.Përditësim i informacionit përkatës. 3.Plotësimi i regjistrave në kohë	Sektor i Financës	Gjatë vitit 2025-2027 dhen ë kohezion	

Objekti i 3 ; Sigurimi i informacionit bashkëkohor për fushën e bujqësisë.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundëshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Intesiteti i riskut/prioriteti	Masat/aktivitetet që duhen ndërmarrë për zbatim/Adresim	Struktura/Njësitë Përgjegjëse	Afati i Zbatimit	Shënime Plotësuese
1.	Mos Planifikim i saktë I organizimit të takimeve në ditë fushë me grupe me fermerë, demonstrime praktike, vizita në fermë, takime individuale, kërkitime në fermë, vrojtime statistikore, grumbullim përpunim të dhënash	Gabimet të mundëshme në realizimin e deyrave dhe vakanca në personel operacional	I mesëm	Njohja me deyrat në funksion të regullores.	Të gjithë sektorët e AREB Tiranë	Gjatë vitit 2025 dhe në kohezion.	
2.	Mos reazim në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të rendesishme të punës.	Ngarkesë e ekstensionistëve për mbulim territori ,dhe me deyra operacional	I lartë	Ndjekja në kohezion të institucionet përgjegjëse me argumentimin përkatës	Burimet Njerzore në bashkëpunim me titullerit e AREB Tiranë	6 Muji i II vitit 2025	
3.	Trajnini i vazhdueshmi stafit të ekstensionit Tiranë në kuadër të Integrimit në BE	Pamundësi për përmbyllje të sfidave të integrimit me efikasitet Operacional	I mesëm	Hartimi i një programi trajnimi në përputhje me kërkesat e kohës	ASPA, QTTB dhe Universiteti Bujësor e AREB Tiranë.	Gjatë vitit 2025 dhe në kohezion.	
4.	Ruajtja e kujesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të struktureve të AREB Tiranë	Mos evidentim i plotë I Data Base në Arshiv nga sektorët e AREB operacional	I modernuar	Materiale informuese të dorëzuar në protokoll për çdo pjesëmarrje në trajnim nga idividët e grupet e punës	Të gjithë sektorët/Arkiv Protokollit	Gjatë vitit 2025 dhe në kohezion	